UDHËZUES I ZBATIMIT TË LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE









Shkup, 2019

Përmbajtja

Fjalë hyrëse 5

Rezyme 7

I. KORNIZA LIGJORE
LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE 7

Përdorimi i gjuhës shqipe në punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 9

Përdorimi i gjuhës shqipe në punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 10

Rregullimi i përdorimit të shqipes në institucionet qendrore 11

Përdorimi i gjuhës shqipe te emrat e institucioneve, vulat dhe zyrat rajonale 12

Përdorimi i simboleve në kartëmonedha, monedha, pulla postare, fletëpagesa, raporte, uniformat etj. 14

Gjuhët zyrtare në procedura gjyqësore dhe procedurat e tjera para organeve të drejtësisë 16

Gjuha në procedurën e ekzekutimit të sankisoneve 18

Gjuha në organet që menaxhojnë me evidencat amzë dhe dokumentet personale dhe të udhëtimit 18

Gjuha gjatë procesit zgjedhor 21

Emërtimi i rrugëve, shesheve dhe objekteve të tjera infrastrukturore si dhe në vendkalimet kufitare 21

Botimet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut 21

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës 22

Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve 23

Dispozitat ndëshkuese në rast të mosrespektimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve 23

II. SI TË ARRIHET STATUSI I BARABARTË I GJUHËVE ZYRTARE 25

Në institucionet qendrore 25

Në institucionet lokale 25

Obligimet e institucioneve për zbatimin e ligjit 26

III. ZBATIMI I LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOMUNIKIM ME QYTETARËT 28
Komunikimi me qytetarët 28
Komunikimi ndërinstitucional 29
Përputhshmëria e ligjeve 29
Publikimet dhe shkresat 29
Raportet vjetore 29
Stemat dhe shenjat identifikuese 30
Vulat 31
Shenjat/ mbishkrimet 31
Faturat 31
Përdorimi i gjuhës në procedurat gjyqësore 31

IV. ROLI I AGJENCISË PËR ZBATIMIN E GJUHËS 32
Si të ankoheni për shkeljen e të drejtës gjuhësore 32

Fjalorth i termave të administrates 34

FJALË HYRËSE

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që të them pak fjalë për Udhëzuesin e Zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, të parin e këtij lloji këtu te ne, me qëllim që të sjellë në një vend legjislacionin, politikat dhe rolin e strukturave institucionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që procesi i respektimit të së drejtës për përdorimin e gjuhës shqipe, si një e drejtë themelore e shqiptarëve, të zbatohet në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme, gjë që është në interesin dhe stabilitetin e kësaj shoqërie ku jetojmë. Para së gjithash kjo do të kontribuojë dukshëm në aspektin e paraqitjes sa më të mirë të institucioneve, për një imazh sa më pozitiv dhe për një nivel sa më të lartë të funksionimit të ligjit.

Gjatë viteve që kemi lënë pas, institucionet e larta shtetërore janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar bazën e mjaftueshme ligjore lidhur me përdorimin zyrtar të gjuhëve, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Siç e kemi të njojhur, Republika e Maqedonisë së Veriut tanimë ka një legjislacion më të avancuar, i cili rregullon më qartë përdorimin e gjuhëve në institucione. Dhe sado që është kompletuar kjo infrastrukturë ligjore për përdorimin e gjuhëve, prapëseprapë, gjatë zbatimit praktik shfaqen vështirësi dhe sfida të ndryshme. Në të vërtetë, ky udhëzues nuk e ndryshon ligjin që është në fuqi, por bën një shpjegim të qartë për sa i përket zbatimit të tij në praktikën shoqërore.

Prandaj, të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve, politikëbërësit, planifikuesit dhe praktikuesit kanë në duar një mjet lehtësues për t'u qasur në informacionet që kanë të bëjnë me detyrimet institucionale ndaj të drejtave të qytetarëve për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më lejoni të falënderoj të gjithë ata që kanë dhënë ndihmesën e tyre të çmuar në hartimin e këtij udhëzuesi.

Prof. dr. Ylber Sela,
drejtor i Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës

REZYME

Qëllimi i këtij udhëzuesi është t'i ndihmojë nëpunësit të zbatojnë Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në mënyrë përkatëse, si dhe t'ua sqarojë qytetarëve të drejtat gjuhësore, çfarë mund të presin ata nga zbatimi i këtij Ligji dhe si mund të veprojnë atëherë kur konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat gjuhësore.

Ky udhëzues përmbledh çështjet më të rëndësishme që janë në mandatin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës, e cila është përgjegjëse për të siguruar, ruajtur, promovuar dhe mbrojtur gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Duke u nisur nga kjo, ky udhëzues praktik dhe ilustrues do të jetë një doracak që konkretisht i orienton qytetarët e RMV-së dhe institucionet përkatëse për të patur në dispozicion informacione të mjaftueshme për sa u përket të drejtave të garantuara me ligj lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare. Për më tepër, ky libër përmbledh brenda vetes edhe çështjet e komunikimit në gjuhët zyrtare, si dhe raportin ndërmjet qytetarit dhe institucioneve e ndërmarrjeve publike.

Zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në këtë udhëzues nuk kufizohet vetëm në fushat e përmendura, por ka një shtrirje shumë më të gjerë. Grupi që ka punuar në përgatitjen e këtij udhëzuesi ka përfshirë atë materie të cilën ka konsideruar se është më praktike dhe parësore për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, si dhe ka udhëzuar se cila është mënyra më e lehtë për të kërkuar zbatimin e të drejtave gjuhësore.

I. KORNIZA LIGJORE
LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Nenet 1, 2, dhe 3 në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve paraqesin bazën mbi të cilën shtrihet përdorimi i gjuhëve zyrtare, përkatësisht gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhës shqipe). Në këto nene përcaktohen institucionet dhe niveli i pushtetit në të cilin ka shtrirje ky ligj. Nëse në pushtetin lokal duhet që këshilli i komunës të vendosë për gjuhët zyrtare, ky ligj vë themelin për zbatimin e gjuhës shqipe në institucionet shtetërore.

Neni 1

(1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.

(3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet,

personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve të cilat i flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Neni 2

(1) Qytetarët kanë të drejtë ta përdorin cilëndo nga gjuhët e theksuara zyrtare dhe alfabetet e tyre nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, ndërsa institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet e tjera e kanë për obligim që t'u mundësojnë qytetarëve shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e atyre gjuhëve zyrtare dhe alfabeteve të tyre në cilëndo qoftë procedurë, si edhe zbatimin e atyre procedurave në atë gjuhë zyrtare dhe në atë alfabet.

(2) Në pajtim me të drejtën e qytetarëve që ta përdorin cilëndo nga gjuhët e cekura zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurat parahetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe për kundërvajtje, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe procedurat e tjera të parapara me ligje të tjera. Gjykatat, prokuroritë publike, si dhe të gjitha organet e tjera, trupat dhe institucionet e tjera janë të obliguara ta mundësojnë shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e cilësdo prej gjuhëve zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në ato procedura dhe në procedura të tjera.

(3) Në institucionet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë nga neni 1 paragrafi (3) i këtij ligji, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj në: komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve të cilat e përbëjnë pushtetin shtetëror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësia, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, gjatë zbatimit të autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, përmbarim, objekte infrastrukturore, evidencën e amzës, dokumentet personale, financat, ekonomi, si dhe në sferat e tjera.

Neni 3

(1) Funksionarë të zgjedhur ose të emëruar të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe institucionet e tjera selia e të cilave është

në Shkup ose komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikimin e tyre zyrtar e përdorin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, nëse së paku njëri prej funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Përdorimi i gjuhës shqipe në punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me nenin 4 rregullohet përdorimi i gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe) në punën e organit më të lartë ligjvënës, Kuvendit, udhëheqja e procedurave të Kuvendit, seancat e trupave punues të Kuvendit dhe seancat plenare, përgatitja e stenogrameve, të drejtat e deputetëve, funksionarëve të emëruar dhe të zgjedhur. Materialet që i parashtrohen deputetit, funksionarëve të emëruar dhe të zgjedhur si dhe të gjitha aktet të cilat burojnë nga puna e Kuvendit janë në dy gjuhë. Publikimi i të gjitha akteve të cilat i sjell Kuvendi bëhet në të dyja gjuhët.

Neni 4

(1) Në punën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj.



(2) Deputeti, funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, në seancën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe në mbledhjet e trupave punues flet edhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

(3) Deputeti, që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë kur kryeson me seancën e Kuvendit ose me mbledhjet e trupave punues, të njëjtat i kryeson në atë gjuhë.

(4) Deputeti, funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, materialet i merr në kohë, përkatësisht i dorëzon edhe në gjuhën dhe alfabetin e tij që të shërbejnë në seancë të Kuvendit ose në mbledhje të trupave punues.

(5) Stenogramet nga seanca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe nga mbledhjet e trupave punues, si dhe materialet dhe dokumentet e tjera lëshohen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në alfabetin e saj.

(6) Të gjitha ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë publikohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Përdorimi i gjuhës shqipe në punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me nenin 5 rregullohet përdorimi i gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), në punën e organit më të lartë ekzekutiv, Qeverisë, udhëheqja e procedurave të Qeverisë, seancat e trupave punues të Qeverisë, përgatitja e stenogrameve, të drejtat e funksionarëve të emëruar dhe të zgjedhur. Materialet të cilat i parashtrohen funksionarëve të emëruar dhe të zgjedhur si dhe të gjitha aktet të cilat burojnë nga puna e Qeverisë janë në dy gjuhë. Publikimi i të gjitha akteve të cilat i sjell Qeveria bëhet në të dyja gjuhët.

Neni 5

(1) Në punën e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj.

(2) Seancat e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë kryesohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

(3) Kur me seancat e Qeverisë të Republikë së Maqedonisë, me mbledhjet e komisioneve, si dhe me Kolegjiumin e përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë kryeson funksionar i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën gjuhë e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, të njëjtat i kryeson në atë gjuhë dhe alfabet.



(4) Funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën gjuhë e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, në komisionet dhe në Kolegjiumin e përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë flet edhe në atë gjuhë.

(5) Funksionari i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën gjuhë e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(6) Stenogramet nga seanca e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nga mbledhja e komisioneve dhe Kolegjiumi i përgjithshëm i sekretarëve shtetërorë, si dhe materialet dhe dokumentet e tjera lëshohen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në alfabetin e saj.

(7) Të gjitha aktet e miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë lëshohen dhe publikohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Rregullimi i përdorimit të shqipes në institucionet qendrore

Neni 6 i ligjit normon mënyrën e komunikimit në rastet kur një person flet shqip, ndërsa institucioni në këtë rast është i obliguar që të flasë edhe shqip. Aktet juridike që burojnë nga institucioni i sipërpërmendur duhet që të jenë në dy gjuhë. Personat që punojnë në këto institucione kanë të drejtë që emrin e tyre ta shkruajnë në shqip, ndërsa sa i përket ueb faqeve të institucioneve detyrimisht duhet që të jenë edhe në shqip.

Neni 6

(1) Institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucionet e tjera janë të obliguara me detyrë zyrtare të sigurojnë që përdorimi, komunikimi dhe procedurat të zhvillohen në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj; nëse personi, përkatësisht pjesëmarrësi flet gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(2) Të gjitha vendimet dhe aktet e tjera, si dhe legjitimacionet që dalin nga kompetenca e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) i këtij ligji, si dhe të gjitha institucioneve të tjera, janë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj nëse personi, përkatësisht pjesëmarrësi flet gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(3) Personi i zgjedhur ose i emëruar që flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, emrin personal në vendimet dhe aktet e tjera në kuadër të kompetencave të institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si edhe në të gjitha institucionet e tjera, e shkruan në gjuhën dhe alfabetin e tij.

(4) Ueb faqet e institucioneve nga neni 1 i këtij ligji dhe përmbajtja e ueb faqeve krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, detyrimisht publikohen edhe në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Përdorimi i gjuhës shqipe tek emrat e institucioneve, vulat dhe zyrat rajonale


Neni 7 i ligjit rregullon zbatimin e gjuhës sa u përket emrave të institucioneve (tabelat), vulat e institucioneve, institucione këto të pushtetit qendror. Gjithashtu neni 7 e rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare edhe në zyrat rajonale të ograneve të pushtetit qendror.

Neni 7


(1) Emrat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të të gjitha institucioneve të tjera si dhe njësive të tyre rajonale në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase edhe në Shkup, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhën angleze. Emrat do të jenë me madhësi shkronjash dhe font të njëjtë, me ç'rast emri në gjuhën maqedonase dhe me alfabetin e saj do të shkruhet i pari.







(2) Në zyrat rajonale të organeve të administratës shtetërore që mbulojnë së paku një njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, emrat e zyrave do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.



(3) Vulat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji dhe të të gjitha institucioneve të tjera me seli në Shkup apo në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe

alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(4) Institucionet nga paragrafi 1 i këtij neni do të mundësojnë dhe kontribuojnë që në punë në mënyrë efektive të shfrytëzohen, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

Shembull: IP, Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale, Prilep – Përveç se e mbulon komunën e Prilepit, e mbulon edhe atë të Krivogashtanit dhe të Dollnenit. Duke pasur parasysh se komuna e Dollnenit, sipas statistikave zyrtare, është komunë ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, përkatësisht shqip, emërtimi i IP, Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale, Prilep duhet të shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

Përdorimi i simboleve në kartëmonedha, monedha, pulla postare, fletëpagesa, raporte, uniformat etj.

Me nenin 8 të ligjit rregullohet përmbajtja e kartëmonedhave, monedhave dhe pullave postare, të cilat do të përmbajnë simbole nga trashëgimitë kulturore të të dyja gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Neni 8 gjithashtu rregullon edhe gjuhët zyrtare që do të përdoren në fatura, raporte fiskale, banderola etj.

Neni 8

(1) Kartëmonedhat dhe monedhat si dhe pullat postare do të përmbajnë simbole që e përfaqësojnë trashëgiminë kulturore të qytetarëve që e flasin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(2) Pullat postare, fletëpagesat, raportet fiskale të lëshuara nga institucionet nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, faturat e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, banderolat, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(3) Uniformat e policisë, të zjarrfikësve, të shëndetësisë; në Shkup dhe në komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

ул.516 бр.10 Скопје1000 Скопје / 1000 Shkup

тел./ tel. +389 2 311 8525
факс./ faks. +389 2 322 9039
Деж.тел./tel.kujd.+38923216644

www.khigiena.com.mk
e-mail:khs@khigiena.com.mk

ЈП КОМУНАЛНА ХИГИЕНА - СКОПЈЕ
NP HIGJIENA KOMUNALE - SHKUP

ЕДБ / Numri tatimor: MK4030992102919

300000000398027	Комерцијална банка Скопје
200000098823689	Стопанска банка Скопје
210045289720181	НЛБ банка Скопје
360016010042297	Поштенска банка Скопје
530010101070538	Охридска Банка Скопје
370011100075815	Еуростандард банка Скопје
320100021627121	Централна Кооперативна
250027000111131	Шпаркасе банка
290000013363741	ТТК банка
270045289720188	Халк банка Скопје

Место / Vendi: СКОПЈЕ / SHKUP

Датум / Data: 30.11.2019

Валута/ Valuta: 08.12.2019

Сметка за месец/ Llogaria për muajin: 11 / 2019

Ф-ра/ Fatura numër: 1119-9331-246775

Сметка број/ Numri i llogarisë:

Корисник/ Shfrytëzues:

Адреса/ Adresa:

ЗАЕДНИЧКИ ДА СЕ ГРИЖИМЕ ЗА ПОЧИСТО СКОПЈЕ
BASHKËRISHT TË KUJDESEMI PËR SHKUP MË TË PASTËR

ОБЈЕКТ (МБ) : 5010709 **УЛ.М.К.У.БРИГАДА БР. 19/13 СКОПЈЕ**

OBJEKTI (NA) :

Шифра на услуга Shifra e shërbimit	Вид на услуга Lloji i shërbimit	Површина Sipërfaqja m2	Категорија Kategoria	Цена денари Çmimi denarë	Даночна основица ИЗНОС Baza tatimore SHUMA	ДДВ TVSH %	Износ на ДДВ Shuma e TVSH	В К У П Н О GJITHËSEJ
751000	**Собирање, транспортирање и третман на комунален отпад** Mbledhje, transportim dhe trajtim i mbeturinave komunale	55	28	3,59	197,00	5	10,00	207,00

Заклучно со/Përfundimisht me 22.11.2019 Вкупен долг/Borxhi i përgjithshëm 0,00 **Доспеан долг/Borxhi i arritur për pagesë 0,00**

РЕДОВНА УПЛАТА, ВИ БЛАГОДАРИМЕ/ PAGESË E RREGULLT, JU FALËNDEROJMË

Повикување на број/ Thirrje në numër: 1119-9331-246775

Плаќањето да се изврши во валутниот рок.
По истекот на валутниот рок се пресметува законска затезна камата.
Во случај на спор надлежен е стварно и месно надлежниот суд во Скопје.
Во случај на промена на податоци известете не во рок од 30 дена.

Pagesa të realizohet në afatin e valutës.
Pas skadimit të afatit të valutës, llogaritet shkalla ligjore dënuese e interesit.
Në rast kontesti kompetent është gjykata me kompetencë lëndore dhe vendore në Shkup.
Në raste të ndryshimit të të dhënave, na njoftoni në afat prej 30 ditëve.

Законски застапник,
Лице овластено за потпишување на фактури,

Përfaqësues ligjor,
Person i autorizuar për nënshkrim të faturave,

Абдусамед Шабани
Abdusamed Shabani

ЈП Комунална хигиена - Скопје / NP Higjiena komunale - Shkup

Повикување на број/ Thirrje në numër:

Вкупно за отпад / Gjithësej për mbeturina

Корисник/ Shfrytëzues:

Gjuhët zyrtare në procedura gjyqësore dhe procedurat e tjera para organeve të drejtësisë

Në nenin 9 është e normuar se cilat procedura gjyqësore do të mund të udhëhiqen në dy gjuhë (maqedonisht dhe shqip), të drejtat e gjykatësve, palëve, prokurorit ose ndonjë pjesëmarrësi tjetër në procedurë sa i përket çështjes së gjuhës. Aktgjykimet, Aktvendimet, por edhe aktet e tjera të cilat burojnë nga procedurat e përmendura në këtë nen duhet të jenë në dy gjuhë nëse ndonjëri nga pjesëmarrësit në procedure flet gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja. Mosrespektimi i dispozitave ligjore në procedura gjyqësore paraqet shkelje esenciale të procedures, mund të rezultojë edhe me prishjen e aktgjykimit.

Neni 9

(1) Në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, procedurat parahetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe të kundërvajtjes, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore, si dhe procedurat e tjera para gjykatave, prokurorive publike, si dhe të gjitha organeve, trupave dhe institucioneve, zbatohet gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

(2) Të gjitha procedurat nga paragrafi (1) i këtij neni mbahen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj, nëse gjykatësi, prokurori publik, pala apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë është person që flet gjuhë, të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.



(3) Të gjitha vendimet, shkresat dhe aktet e tjera që dalin nga procedurat nga paragrafi (1) i këtij neni miratohen dhe botohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj nëse gjykatësi, prokurori publik, pala apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë është person që e flet gjuhën, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(4) Institucionet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni obligohen që të mundësojnë përkthimin e të gjitha dokumenteve dhe materialeve të nevojshme, si dhe përkthimin simultan të ekspozeve, deklaratave dhe seancave gjyqësore në punën apo procedurat që mbahen.

(5) Mossigurimi i përkthimit të të gjitha dokumenteve dhe materialeve të nevojshme, përkatësisht mossigurimi i përkthimit simultan gjatë tërë kohëzgjatjes së procedurës paraqet shkelje esenciale të procedurës.

(6) Emrat e institucioneve të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(7) Në institucionet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni me seli në rajonin që përfshin më shumë gjykata themelore prej të cilave së paku njëra prej tyre gjendet në njësinë e vetëqeverisjes lokale në të cilën flitet gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja, e të cilën e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, emrat gjithashtu do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

(8) Shpenzimet që krijohen nga përkthimi për palët dhe pjesëmarrësit në procedurë, si dhe shpenzimet për përkthyes gjyqësor që krijohen me zbatimin e dispozitave të këtij ligji, janë barrë e mjeteve të institucioneve të theksuara në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 10

(1) Në procedurat para noterit, dokumentet noteriale dhe verifikimet mund të lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

(2) Në procedurat para përmbaruesit, nëse pjesëmarrësi është person që e flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, urdhëresat, konkluzionet, procesverbalet, shënimet zyrtare dhe aktet e tjera të përmbaruesve lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Shembull: Në gjykatën themelore Shkupi I - Shkup, zhvillohet procedurë penale kundër perosnit të akuzar, kryetari i këshillit gjykues flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja (shqip). Për shkak të gjendjes faktike të këtillë dhe përbërjes së këshillit gjykues, procedura penale duhet të udhëhiqet përveç në gjuhën maqedonase dhe shkrimin e saj, edhe në gjuhën që e flet gjykatësi, nëse është gjuhë zyrtare.

Shembull: Para përmbaruesit ka arritur titulli ekzekutiv për përmbarimin e një kërkese të kreditorit, nëse në këtë procedurë ka ndonjë pjesëmarrës që flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, atëherë detyrimisht procedura duhet që të zhvillohet në dy gjuhë.

Gjuha në procedurën e ekzekutimit të sankisoneve

Organet të cilat menaxhojnë me ekzekutimin e sanksioneve, si drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, por edhe shtëpitë ndëshkuese-korrektuese (burgjet) janë të detyruar që të gjatë punës së tyre t'i zbatojnë të dy gjuhët.

Neni 11

(1) Institucionet kompetente për menaxhim me institucionet për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe vetë institucionet kompetente për ekzekutimin e sanksioneve obligohen që në komunikim dhe në procedura ta zbatojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj nëse personi për të cilin bëhet fjalë flet gjuhë që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(2) Institucionet kompetente për menaxhim me institucionet për ekzekutimin e sanksioneve si dhe institucionet kompetente për ekzekutimin e sanksioneve obligohen të mundësojnë që personat të cilët gjenden në këto institucione të flasin edhe në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Gjuha në organet që menaxhojnë evidencat amzë dhe dokumentet personale e të udhëtimit

Në nenin 12 të ligjit rregullohet çështja e mbajtjes së evidences, përkatësisht përveç lëshimit të certifikatave në gjuhën që e flet qytetari, institucioni është i obliguar që evidencat t'i mbajë edhe në shqip.

Neni 12, 13 dhe 14 i ligjit rregullon çështjen e dokumenteve personale dhe dokumenteve të udhëtimit të qytetarëve, nëse qytetari flet gjuhë zyrtare, shqip, atëherë ai dokument duhet të jetë në maqedonisht dhe në shqip. Me kërkesë të qytetarit përmbajtja e letërnjoftimit, pasaportës mund që të jetë në dy gjuhë.

Neni 12

(1) Evidencat e amzës në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja mbahen edhe në gjuhën zyrtare që e flet qytetari.

(2) Aktvendimet, certifikatat, vërtetimet si dhe aktet e tjera botohen edhe në gjuhën zyrtare që e flet qytetari.

БАРАЊЕ/KËRKESË

за издавање на ***ИЗВОД ОД МАТИЧНАТА КНИГА НА УМРЕНИТЕ***
për lëshimin e ***CERTIFIKATËS NGA LIBRI AMZË I TË VDEKURVE***

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË
МИНИСТЕРСТВО ЗА ПРАВДА
MINISTRIA E DREJTËSISË
УПРАВА ЗА ВОДЕЊЕ НА МАТИЧНИТЕ КНИГИ
DREJTORIA PËR UDHËHEQJEN E LIBRAVE AMË
Подрачно одделение _____
Seksioni rajonal
Подрачна канцеларија _____
Zyra rajonale
Месна канцеларија _____
Zyra e vendit

Податоци за умрениот Të dhëna për të vdekurin	Име, татково име Emri, emri i babait	
	Презиме(за мажени и mominsko) Mbiemri (për të martuarat edhe i vajzërisë)	
	Единствен матичен број на граѓанинот Numri amzë i qytetarit	
Податоци за смртта Të dhëna për të vdekjen	Ден, месец, година Dita, muaji, viti	
	Место, општина Vendi, komuna	
Изводот е наменет за: Certifikata mund të përdoret për:		

Подносител на барањето(име,презиме)
Parashtruesi i kërkesës (emri,mbiemri)

_____

Адреса на живеење
Adresa e vendbanimit

_____
(Улица,број,населено место)
(Rruga, numri, vendbanimi)

Потребно е:
Nevojiten:
100 ден. Адм.такса
100 den.Taksë administrative
50 ден. уплатница
50 den. fletpagesë

Дата на поднесување
Data e parashtresës

_____
(ден,месец,година)
(dita, muaji, viti)

(3) Dokumentet personale dhe dokumentet e udhëtimit të qytetarëve që flasin në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, me detyrë zyrtare lëshohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 13

(1) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, formulari i letërnjoftimit shtypet edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.


(2) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në letërnjoftim shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.

Neni 14

(1) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre, formulari i dokumentit të udhëtimit dhe fletudhëtimi shtypet edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.

(2) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat që shënohen në dokumentin e udhëtimit dhe në fletudhëtim shkruhen edhe në atë gjuhë dhe alfabet.

(3) Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në dokumentin e udhëtimit shkruhen edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.



Gjuha shqipe gjatë procesit zgjedhor

Gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor sipas nenit 15 të ligjit, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve dhe komisionet komunale të zgjedhjeve që gjenden në komunat ku së paku 20% e qytetarëve flasin shqip, atëherë puna e komisioneve zhvillohet në dy gjuhë.

Neni 15

Në mbledhjet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të komisioneve komunale të zgjedhjeve në Shkup dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, gjatë realizimit të zgjedhjeve, në punën dhe procedurat e të gjitha komisioneve si dhe trupave dhe institucioneve të tjera, në mënyrë të barabartë shfrytëzohen, përdoren dhe zbatohen gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

Emërtimi i rrugëve, shesheve dhe objekteve të tjera infrastrukturore si dhe në vendkalimet kufitare

Neni 16 përcakton se në të gjitha komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhën shqipe, në Shkup, rrugët, sheshet dhe objektet e tjera infrastrukturore duhet që të shkruhen në maqedonisht dhe shqip si dhe në njërën nga gjuhët më të përdorura ndërkombtarisht.

Neni 16

(1) Emri i rrugës, sheshit, urës dhe i objektit tjetër infrastrukturor në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, si dhe në Shkup, shkruhet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhët që janë të pranuara përgjithësisht nga bashkësia ndërkombëtare.

(2) Në vendkalimet kufitare të Republikës së Maqedonisë dhe aeroportet që gjenden në rajonin ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, emrat e institucioneve, mbishkrimet e tjera dhe udhërrëfyesit shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Botimet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në Gazetë Zyrtare të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet, shpalljet etj. botohen në të dyja gjuhët zyrtare.

Neni 17

(1) Të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet e institucioneve nga neni

1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, që botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, botohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës

Mënyra e funksionimit, zgjedhja e drejtorit, mandati i drejtorit si dhe kompetencat e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës janë të parapara në nenin 18 dhe 19 të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve.

Neni 18

(1) Për realizimin e qëllimeve të këtij ligji, për promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e barabartë të gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetit të saj, themelohet Agjencia për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) me cilësinë e personit juridik, kompetente për standardizimin dhe përdorimin e barabartë të gjuhës të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetit të saj me trupat ndihmëse për mbështetjen e institucioneve nga neni 1 paragrafi (3) dhe neni 2 paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucioneve të tjera.

(2) Drejtorin e Agjencisë e zgjedh Qeveria e Republikës së Maqedonisë me thirrje publike të shpallur paraprakisht, me mandat prej 4 vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.
(3) Në Agjenci, krahas përkthyesve të autorizuar gjyqësorë punësohen edhe linguistë dhe filologë të diplomuar të gjuhës shqipe, si dhe lektorë të licencuar.

(4) Drejtori e përfaqëson Agjencinë, udhëheq me punën e saj, i kryen punët e përcaktuara me këtë ligj dhe miraton program vjetor për punën e Agjencisë. Drejtori paraqet raport për punën e Agjencisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së paku një herë në vit deri më 31 mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(5) Mjetet për punën dhe funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 19

Agjencia është kompetente për:

- dhënien e mbështetjes institucioneve në realizimin e obligimeve që burojnë nga ky ligj, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- lekturimin e të gjitha akteve që botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë;
- promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- hartimin e raporteve për informimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e kompetencave të saj;

- përgatitjen e materialeve analitike-profesionale nga kompetenca e saj për nevojat e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë;
- dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- punë të tjera lidhur me zbatimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve

Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve është institucion i veçantë, i cili do të bëjë monitorimin e zbatimit të ligjit, për këtë është sjellë ligj i veçantë, i cili do të përcaktojë mënyrën e zgjedhjes së drejtorit, mandatit, kompetencat e përcaktuara, mënyra e punës dhe çështje të tjera organizative dhe funksionale për mbarëvajtjen normale të këtij institucioni.

Neni 20

(1) Për mbikëqyrje mbi zbatimin e plotë dhe konsekuent të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, themelohet Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve (në tekstin e mëtejshëm: Inspektorati), në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë me cilësi të personit juridik.

(2) Parimet, kompetenca, organizimi i inspektimit dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese të Inspektoratit për Përdorimin e Gjuhëve rregullohen me ligj të veçantë.

Qeveria si institucioni më i lartë ekzekutiv është e obliguar për të ndërmarrë masa që të promovohen gjuhët zyrtare (maqedonishtja dhe shqipja) në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në nenin 23 Qeveria është e obliguar që të krijojë një program për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve.

Neni 21

Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, do të miratojnë masa për promovimin e zbatimit të të gjitha gjuhëve zyrtare, si dhe për garantimin e mbrojtjes së gjuhëve të bashkësive të tjera, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare.

Dispozitat ndëshkuese në rast të mosrespektimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve

Neni 22

(1) Gjobë në shumë prej 4.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'u shqiptohet organeve të theksuara në nenin 1 paragrafi (3), nenin 2 paragrafi (3), si dhe të gjitha institucioneve të tjera për mosrespektimin e dispozitave të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% të gjobës së përcaktuar do t'i shqiptohet personit zyrtar dhe personit përgjegjës në organet nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 23 përmban dispozitat përfundimtare dhe kalimtare, me këtë nen përcaktohen situata të veçanta në lidhje me zbatimin e ligjit, përshtatjen e ligjeve të tjera me këtë ligj dhe akteve nënligjore të përcaktuara me afat kohor, si dhe është caktuar se në rast të mospërshtatjes së ligjeve të tjera me këtë ligj, do të zbatohet ky ligj.

Neni 23

(1) Në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, të gjitha institucionet kompetente obligohen që t'i miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

(2) Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, institucionet obligohen t'i zbatojnë obligimet e theksuara në nenin 7 të këtij ligji.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zhvillojë program për ngritjen e vetëdijes publike për zbatimin e këtij ligji.

(4) Në afat prej një viti, dispozitat e ligjeve të tjera harmonizohen me dispozitat e këtij ligji.

(5) Në rast të mosharmonizimit të dispozitave të këtij ligji me dispozitat gjuhësore të ligjit tjetër, organet kanë për detyrë t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

Neni 24

Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 101/08 dhe 100/11).]

Ligji për Përdorimin e Gjuhëve hyn në fuqi ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare, përkatësisht më datë 14. 01. 2019.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

II. SI TË ARRIHET STATUSI I BARABARTË I GJUHËVE ZYRTARE

Legjislacioni është instrumenti kryesor i institucioneve publike që rregullon raportet ndërmjet institucioneve, raportet e individëve dhe institucioneve dhe individëve ndërmjet veti. Korniza ligjore për dygjuhësinë është thelbësore që legjislacioni të jetë njësoj i qasshëm dhe i saktë në të dyja gjuhët zyrtare në mënyrë që të jetë efektiv. Meqenëse të drejtat gjuhësore janë pjesë integrale e së drejtës themelore të njeriut mbi lirinë e shprehjes, përmbushja e tyre është jetike për të siguruar që pjesëtarët e të gjitha komuniteteve të mund të marrin pjesë në mënyrë efektive në shoqëri dhe të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Si të tilla, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ku të drejtat gjuhësore janë paraparë në kornizë ligjore, ato duhet respektuar me kujdes gjatë hartimit, shpalljes dhe zbatimit të legjislacionit.

Në institucionet qendrore

Institucionet publike të pushtetit shtetëror duhet të aplikojnë modelin e decentralizuar të zbatimit të dispozitave të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve, sepse vlerësojmë se ky model i decentralizuar do të ishte më efikasi dhe do të jepte rezultate më të frytshme, duke pasur parasysh këtu vëllimin e punës dhe kohën për realizimin e të njëjtës.

Çfarë nënkuptojmë me sistemin e decentralizuar? Secili organ i pushtetit shtetëror do të ndërmarrë hapa për të sjellë të gjitha aktet e tyre në dy gjuhë, pra çdo propozim ligj nga ministritë duhet që të jetë në dy gjuhë dhe për këtë është e nevojshme që ministritë të krijojnë kapacitete për zbatimin e dispozitave të ligjit, qoftë ajo duke punësuar përkthyes dhe bërë trajnimin adekuat të tyre, por edhe furnizimin e tyre me softuer të përkthimit ose pajisje të ngjashme.

Institucionet qendrore u sigurojnë qytetarëve komunikim në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe, si dhe dokumentet publike ua ofrojnë në këto dy gjuhë. Kjo nënkupton përkthimin në mbledhje, në takime publike të organizuara nga këto institucione; vendosjen e shenjave dhe mbishkrimeve; komunikimin duke ofruar një mjedis të favorshëm për përdorimin e gjuhëve zyrtare nga të punësuarit.

Në institucionet lokale

Statusi i barabartë i përdorimit të gjuhëve zyrtare në nivel lokal arrihet kur institucionet përkatëse sigurojnë që komunikimi me qytetarët të zhvillohet në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.

Sipas kërkesës, institucionet lokale duhet të ofrojnë dokumente dhe informacione në gjuhën amtare të personit, gjuhë e cila është në përdorim zyrtar.

Republika e Maqedonisë së Veriut për institucionet e pushtetit lokal e ka rregulluar çështjen e gjuhës me ligjin për vetëqeverisje lokale, përkatësisht ky ligj thotë, për gjuhët zyrtare nëpër komuna vendos Këshilli i komunës.



Duhet theksuar se në nivel lokal, në dallim nga ai qendror ka më shumë gjuhë zyrtare, si për shembull, në Komunën e Çairit gjuhë zyrtare janë maqedonishtja, shqipja dhe turqishtja; ndërsa në Komunën e Kumanovës gjuhë zyrtare janë maqedonishtja, shqipja, turqishtja dhe serbishtja.

Nëse Këshilli i komunës sjell vendim për përdorimin e një gjuhe tjetër si gjuhë zyrtare, atëherë ato gjuhë janë të barabarta në nivel lokal.

Obligimet e institucioneve për zbatimin e ligjit

Institucionet duhet t'i marrin masat e nevojshme për zbatimin e plotë të ligjit përkatës, në mënyrë që t'i realizojnë të drejtat gjuhësore sipas Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Të sigurohen dokumentacioni publik dhe informacionet në gjuhët zyrtare në nivel qendror dhe lokal.


Të respektohet barazia gjuhësore në të gjitha dokumentet publike që dalin nga institucionet.

Materialet shoqëruese që përdoren për komunikim ndërinstitucional të jenë në gjuhët zyrtare.

Shenjat topografike të jenë të evidentuara mirë në të gjitha gjuhët, duke respektuar barazinë gjuhësore.

Të harmonizohen faqet zyrtare të internetit sipas gjuhëve zyrtare në të gjitha institucionet.

Përcjellja e informacioneve në gjuhët zyrtare të bëhet në të njëjtën kohë.



III. ZBATIMI I LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE GJATË KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Gjatë komunikimit me qytetarët, që mesazhi të kuptohet lehtësisht, gjuha e përdorur nga institucionet duhet të jetë e kuptueshme, e qartë dhe e thjeshtë. Edhe gjatë komunikimit ndërinstitucional shkresat duhet të jenë qarta, pa ngarkesa dhe shprehje metaforike. Zakonisht aktet bazohen në ligj dhe rregullore dhe si të tilla nuk duhet të komplikohen dhe ngarkohen me figura letrare.

Asnjë shkresë, asnjë akt i përgatitur nga një institucion nuk duhet të ngjallë hamendësime dhe dilema. Ky komunikim njerëzor e zyrtar, me rregullat e sipërpërmendura, duhet të zbatohet edhe nga nëpunësit nëpër sportelet e të gjitha institucioneve, pa paragjykime nëse duhet përdorur njërën apo gjuhën tjetër.

Qëllimi i organeve shtetërore dhe lokale duhet të jetë shërbimi efikas i qytetarëve. Në asnjë mënyrë nuk duhet krijuar distancë gjatë shërbimeve dhe komunikimit publik.

Të shkruarit dhe të komunikuarit institucional nënkupton një komunikim të pagabueshëm, të qartë, pa fjalë të huaja e të pakuptueshme, pa zhargone. Të gjithë duhet ta përdorin gjuhën standarde! Të gjitha institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut e kanë për detyrë t'i përgjigjen qytetarit në gjuhët zyrtare, që tanimë dihet se janë gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe. Ky komunikim me qytetarët mund të bëhet edhe nëpërmjet ueb faqeve kur të gjitha informaciont duhet të jenë në të dyja gjuhët zyrtare.

Institucionet e pushtetit lokal kanë një përparësi nga ato të pushtetit qendror pasi që disa vite me radhë kanë zbatuar dygjuhësinë dhe telashet gjuhësore pothuaj i kanë tejkaluar. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se komunat dhe ndërmarrjet publike komunale nuk duhet t'i përditësojnë informacionet e tyre, duke i ndrequr gabimet dhe të metat gjuhësore.

Komunikimi me qytetarët

Komunikimi me publikun nga institucionet bëhet në mënyra të ndryshme, përmes komunikatave për medie, konferencave për shtyp, rrjeteve sociale, telefonit, letrave, shkresave, qoftë përmes postës së regjistruar ose asaj elektronike.

Materialet informuese, fletëpalosjet, broshurat, doracakët, shpalljet, ftesat për propozime, konkurset dhe ueb faqet elektronike – duhet të jenë të shkruara dhe të publikuara në gjuhët zyrtare. Institucionet publike janë të obliguara që secili informacion që i ofrohet publikut të jetë në të njëjtën kohë në gjuhët zyrtare. Sportelet duhet të ofrojnë shërbime në dy gjuhë; nëse ofruesi i shërbimit nuk i flet të dyja gjuhët, atëherë institucioni është i obliguar që të hapë sportel edhe në gjuhën shqipe. E njëjta gjë vlen edhe për shërbimet arkivore.

Është koha që të distancohemi nga gjuha e përditshme politike dhe gjuha e urrjetjes. Komunikimi dhe informimi duhet kryer nga ekspertët e gjuhës dhe të ligjit. Të

parët për t'i eliminuar gabimet drejtshkrimore dhe përmbajtësore, ndërkaq të dytët për t'i korrigjuar dhe hartuar sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në RMV.

Komunikimi ndërinstitucional

Komunikimi ndërinstitucional duhet të bëhet në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

Të gjitha shkresat, kërkesat apo ankesat që ndihmojnë komunikimin ndërinstitucional, duhet të jenë në gjuhët zyrtare. Institucionet duhet të përgjigjen në gjuhën në të cilën ka ardhur shkresa, kërkesa apo ankesa.

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës ka intervenuar në rastin kur nga një institucion ka marrë një njoftim dhe një formular që u janë dedikuar shërbyesve qytetarë për ta plotësuar, por ato kanë qenë vetëm në njërën gjuhë zyrtare. Janë ndërmarrë masat e duhura dhe çështja është rregulluar.

Ueb faqet e institucioneve duhet të jenë në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe. Përmbajtja dhe përditësimi i tyre duhet të kenë trajtim të barabartë.

Konkurset, shpalljet dhe ftesat për propozime duhet të publikohen në gjuhët zyrtare në nivel qendore dhe në atë komunal. Kjo nënkupton që të gjitha informatat sqaruese duhet të sigurohen dhe të publikohen në të dyja gjuhët zyrtare.

Përputhshmëria e ligjeve

Të gjitha aktet normative që miratohen nga institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, duhet të jenë në pajtueshmëri me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Publikimet dhe shkresat

Me qëllim të avancimit të komunikimit me publikun, institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ato të nivelit qendror dhe lokal, janë të detyruara të publikojnë informacione të ndryshme, publikime dhe dokumente të ndryshme, që konsiderojnë se janë të rëndësishme për publikun.

Institucionet i bëjnë publikimet në maqedonisht dhe në shqip, varësisht se cilit nivel i përkasin. Publikime të tilla bëjnë edhe ndërmarrjet publike, të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për qytetarët.

Një proces tjetër që duhet të jetë në përputhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve është edhe rregullimi i softuerëve, të cilët merren me përgatitjen e dokumenteve të ndryshme.

Raportet vjetore

Institucionet e nivelit qendror janë të detyruara të përpilojnë dhe t'i bëjnë publike raportet vjetore në të dyja gjuhët zyrtare.

Në të gjitha këto dokumente duhet të respektohet barazia gjuhësore (të jenë të shkruara sipas normave gjuhësore, të kenë trajtim të barabartë dhe të botohen në të njëjtën kohë, pra njëkohësisht).

Institucionet lokale janë të detyruara të hartojnë dhe të botojnë raportin vjetor në gjuhët zyrtare të komunës.

Në grupin e këtyre dokumenteve hyjnë:

- Rregulloret, vendimet,
- Raportet e auditimit,
- Shkresat udhëzuese,
- Buletini dhe dokumentet e tjera.

Institucionet lokale janë të detyruara t'i publikojnë të gjitha aktet normative, siç janë:

- Statuti i Komunës,
- Strategjitë,
- Rregulloret komunale,
- Plani i Punës,
- Raportet (Raporti i Auditimit),
- Raporti Vjetor dhe Raporti Financiar.

Istitucionet komunale janë të detyruara që, sipas kërkesës së qytetarëve, të publikojnë dhe të përkthejnë dokumentacionin edhe në gjuhët që janë në përdorim zyrtar në komuna.

Edhe ndërmarrjet publike që kryejnë shërbime me interes për qytetarët, janë të detyruara të zbatojnë barazinë gjuhësore në këto dokumente:

- Statutin e ndërmarrjes,
- Rregulloret,
- Planet,
- Raportet,
- Aplikacionin e shërbimeve,
- Kërkesat e konsumatorëve,
- Kontratat e furnizimit të konsumatorëve me shërbime,
- Formularin e ankesave.

Stemat dhe shenjat identifikuese

Të gjitha institucionet janë të detyruara që në stemat dhe shenjat e tyre identifikuese të respektojnë të dyja gjuhët zyrtare, varësisht se cilit nivel i takon institucioni.

Vulat

Të gjitha institucionet janë të detyruara që gjatë gravurës së vulave të respektojnë barazinë gjuhësore. Teksti i vulës së institucionit duhet të shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit me madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Ligji i Përdorimit të Gjuhëve).

Teksti i vulës së institucioneve komunale duhet të shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit me madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të komunave (Neni 7 i Ligjit).

Shenjat / mbishkrimet

Çdo institucion a organ publik ka për detyrë të sigurojë që shenjat/mbishkrimet të vendosen në gjuhët zyrtare, varësisht nga rrethanat dhe vendi ku ndodhen (neni 7 i Ligjit), shkronjat të kenë të njëjtin font, madhësi, ngjyrë e renditje të njëjtë.

Institucionet qendrore janë të detyruara të zbatojnë ligjin në mbishkrimet e institucioneve (Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (neni 7).

Çdo institucion në nivel lokal është i detyruar që shenjat topografike që shënojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave si dhe të vendeve e të hapësirave të tjera publike, të jenë në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e bashkësive, gjuha e të cilave ka statusin e gjuhës zyrtare në komunë.

Emrat e qyteteve dhe vendbanimeve duhet të shkruhen në variantet e gjuhëve zyrtare.

Faturat

Ndërmarrjet që janë në pronësi publike dhe shoqërore (por edhe ato private) duhet ta zbatojnë barazinë gjuhësore. Të gjitha këto ndërmarrje janë të detyruara që faturat t'i përgatisin në gjuhët zyrtare (neni 8 i Ligjit).

Përdorimi i gjuhës në procedurat gjyqësore

Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë për arsyet e privimit, në gjuhën që e flet ai/ajo. (Neni 9 i Ligjit).

Sipas legjislacionit në fuqi, në të gjitha procedurat gjyqësore, institucioni përgjegjës duhet të respektojë të drejtën e çdo personi që në procedurë të përdoret cilado gjuhë që zgjedh ai/ajo. Qytetarët kanë të drejtë të komunikojnë dhe të kërkojë shërbime në gjuhën e tyre amtare.

Të gjitha procedurat, dokumentet, njoftimet dhe shkresat duhet të ofrohen në gjuhët zyrtare për çdo person, gjuha e të cilit nuk është zyrtare ose në përdorim zyrtar (neni 9 i Ligjit).

Institucionet ndëshkimore korrektuese, burgjet etj. janë të detyruara të ofrojnë ndihmë në përkthim dhe në komunikim për të gjithë këta persona si dhe punën e tyre ta bëjnë në dy gjuhë. (neni 11 i Ligjit).

IV. ROLI I AGJENCISË PËR ZBATIMIN E GJUHËS

AZGJ-ja kujdeset për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në tërësi siç është e paraparë në kompetencat e saj të theksuara në ligj. Merr masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë, bën rekomandime për sa i përket konsistencës së secilit akt administrativ dhe ofron këshilla ligjore për qytetarët, institucionet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre që burojnë nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 7/19). Themelimi i Agjencisë bazën e saj e ka në ligj, ndërsa është nën Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, së cilës i jep raport.

AZGJ-ja ka kompetencë:

- dhënien e mbështetjes institucioneve në realizimin e obligimeve që burojnë nga ky ligj, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- lekturimin e të gjitha akteve që botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë;
- promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- hartimin e raporteve për informimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e kompetencave të saj;
- përgatitjen e materialeve analitike-profesionale nga kompetenca e saj për nevojat e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë;
- dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë;
- punë të tjera lidhur me zbatimin e qëllimeve të përcaktuara në këtë ligj.

SI TË ANKOHENI PËR SHKELJEN E TË DREJTËS GJUHËSORE

- **Personalisht**
- **Nëpërmjet telefonit:** Tel: +389 72 916 708
- **Nëpërmjet postës elektronike në:** ankesa@apj.gov.mk
- **Nëpërmjet postës:**

Agjencia për Zbatimin e Gjuhës, shëtitorja "Dimitar Vllahov", nr. 4, kati IV, 1000, Shkup.

Ankesa mund të bëhet në cilëndo nga gjuhët zyrtare, duke shkarkuar dhe plotësuar formularin. Këta formularë janë në dispozicion për qytetarët në gjuhën maqedonase dhe në atë shqipe, në faqen zyrtare të AZGJ-së, www.apj.gov.mk, por edhe zyra mund të ndihmojë për plotësimin e tyre.

ANKESË / ЖАЛБА

Parashtruesi i ankesës / Подносителот на жалбата

Име/Emri /Name: _____
Презиме/Mbiemri/Surname: _____
Адреса/Adresa/ Address: _____
Поштенски код, место и општина/Kodi postar, vendi dhe komuna/ Postal code, country and municipality:

_____

Тел. Бр./Nr.tel / Tel. Nr _____
Е- пошта/E-mail/E-mail: _____

Дали сакате вашите лични податоци да останат доверливи при разгледување на жалбата?/ /A dëshironi që të dhënat tuaja personale të mbeten konfidenciale gjatë shqyrtimit të ankesës?/ Do you want your personal information to remain confidential during the review of the complaint?

Да / Po / Yes ☐ Не/Jo/No ☐

За која институција се жалите? /Ndaj cilit institucion ankoheni?/Which institution do you complain about?

_____
_____

Дали сте се пожалиле до соодветната институција? Ако да, наведете детали на жалбата и на евентуалниот одговор./A jeni ankuar në institucionin përkatës? Nëse po, jepni detajet e ankesës dhe përgjigjes eventuale./ Have you complained to the relevant institution? If so, provide details of the complaint and eventual response.

Да / Po / Yes ☐ Не / Jo / No ☐

_____
_____
_____

Ве молиме опишете ја жалбата кратко и јасно!/ Ju lutemi, përshkruajeni ankesën shkurt dhe qartë!/ Please describe the complaint briefly and clearly!

_____
_____
_____
_____
_____
_____

По можност, в е молиме , испратете ни ги приложените копии од документите и доказите кои ја поддржуваат вашата жалба! / Ju lutemi, nëse është e mundur, na dërgoni të bashkëngjitura kopjet e dokumenteve dhe dëshmitë që mbështesin ankesën tuaj!/
Please, if possible, send us attached copies of the documents and evidence supporting your complaint!

Потврди дека горенаведените податоци се точни и целосни!
Vërtetoi se të dhënat e sipërpërmendura janë të sakta dhe të plota!
Confirmed that the above data is accurate and complete!

Подносител на жалбата:
Parashtruesi i ankesës: Датум/ Data/ Date
The complainant:

_____ _____

FJALORTH I TERMAVE TË ADMINISTRATËS

А

абдицира – abdikoj, heq dorë (nga një e drejtë)
абдикација – abdikim
аберација – shmangie
абецеда – alfabet
абецедар – listë apo regjistër me rend alfabetik
абецеден – alfabetik
аболиција – abolicion, falje
аброгација – abrogim (anulim, shfuqizim)
аброгира – abrogoj, suprimoj
аванс – avancë, paradhënie
авансира – jap avancë, paradhënie
аверзија – averzion, mospëlqim
аверс – avers, faqja (ana) e parme e monedhës
авијација – aviacion
автентичен – autentik
автентичност – autenticitet
автобиографија – autobiografi, jetëshkrim i hartuar nga vetë autori
автономија – autonomi
автократија – autokraci
авторитет – autoritet
авторитетен – autoritativ
авторство – autorësi
агент – agjent
агенција – agjenci
агресија – agresion
адвокат – avokat
адвокатура – avokaturë
административен (управен) – administrativ
администратор – administrator, administrues
адмнистрирање – administrim
администрација – administratë
акламација – aklamacion
акредитација – akreditim
акредитиви – kredenciale
акт (чин) – akt, vepër
актива – aktivë
активен – aktiv
активност – aktivitet
акциза – akcizë
акција – aksion
акционер – aksionar
алиби – alibi
алиментација – alimentacion, ushqim
акција – aksion
акционер – aksionar
алиби – alibi
алиментација – alimentacion, ushqim
алијанса – aleancë
алоцира – alocon
алокација – alokim, shpërndarje
амандман – amendament
амбасадор – ambasador
амнестија – amnisti
анархија – anarki
анекс – aneks
анексија – aneksim
антидатира – paradatoj
ануитет – anuitet, arkëtim vjetor
апанажа – apanazh
апартхејд – aparteid
апел – apel, thirrje
апелационен – i apelit
апсење – arrestim, burgosje
аранжман – aranzhman
арбитрарен – arbitrar
арбитража – arbitrazh
аргумент – argument
армија – armatë
арсенал – arsenal
асимилира – asimiloj
асмилација – asimilim
асистенција – asistim, ndihmesë
асоцијација – asociacion, shoqatë
асоцира – asocoj, ndërlidh
аспирант – aspirant
аспирација – aspiratë
атакува – atakoj, sulmoj
аташе – atashe
аукција – ankand, auksion

Б

база – bazë
банка – bankë
банкар – bankier
банкротирање – bankrotim
барање – kërkesë
барател – kërkues
бариера – barrierë
бегалец – i arratisur
бегство – arrati, arratisje, ikje
безбедност – siguri
безредие – prishje rendi
безусловен – i pakushtëzuar
беззначаен – i parëndësishëm
бележи – shënoj
белешка – shënim
берза – bursë
бесмислен – i pakuptimtë
бесплатен – falas, pa pagesë
бесправен – i padrejtë
бизнис – biznes
биланс – bilanc
билтен – buletin
биографија – biografi
биро – ent
бирократија – burokraci
благовремен – në kohë (të duhur)
бланко – i zbrazët, i pashkruar
блокада – bllokadë
богатство – pasuri
боледување – raport mjekësor
борд – bord
брак – martesë, kurorë
брани – mbroj
бранител – mbrojtës
брачен – martesor, bashkëshortor
број – numër
бунт – rebelim
буџет – buxhet

В

важен – i rëndësishëm
важност – vlefshmëri
валоризација – valorizim
валута – valutë
вандализам – vandalizëm
вградува – inkorporoj
велепредаство – tradhti

венчавање – kurorëzim, celebrim
верба – besim
верен – besnik
верификација – verifikim
верност – besnikëri
веродостоен – autentik
веродостојност – autenticitet
вето – veto
ветување – premtim
вешт – i shkathët
вештак – ekspert
вештачки – artificial
вештина – shkathtësi
взаемен – reciprok
вина – faj
виновен – fajtor
виновник – fajtor
виновност – fajësi
вистина – e vërtetë
вистинит – i vërtetë
вишок – tepricë
вкрстување – kryqëzim
влада – qeveri
владеење – sundim
владение – zotërim
владетел – sundues, sundimtar
владин – qeveritar, i qeverisë
власт – pushtet
влијае – ndikoj
вложување – investoj
влошува – përkeqësoj, acaroj
вмешување – përzierje
внатрешен – i brendshëm
внимателен – i kujdesshëm
вовед – hyrje
воведување – vë, shtie, vendos (në praktikë), fut, inkorporoj, përfshij
води – mbaj, çoj, udhëheq, kryesoj, menaxhoj
водостопанство – ekonomi e ujërave
воен – ushtarak, luftarak
воздржан – i përmbajtur, abstenoj
вознемирување – shqetësim
возрасен – madhor, i rritur
војна – luftë
војска – ushtri
волја – vullnet, dëshirë
вонбрачен – jashtëmartesor,
вонреден – i jashtëzakonshëm, i veçantë, i posaçëm
вооружен – i armatosur
вработен – i punësuar
вработува – punëson
врачува – dorëzoj, dërgoj
врачување – dorëzim, dërgim
вредност – vlerë
времена – i përkohshëm
врховен – suprem, më e lartë

Г

гаранција – garanci
(по) глава на жител – për kokë banori
главен – kryesor
глас – votë
гласа – votoj
гласење – votim
гласач – votues
говор – fjalim
говорник – orator, folës
гонење – ndjekje
гонител – ndjekës
гордост – krenari
горенаведен – i sipërshënuar, i lartpërmendur
грабеж – grabitje, plaçkitje
грабнува – rrëmbej, grabit
грабнувач – rrëmbyes, grabitës
граѓански – civil, qytetar
граница – kufi
граничен – kufitar
грешка – gabim
грижа – kujdes, përkujdesje

Д

давачки – detyrime
данок – tatim
даночен – tatimor
движење – lëvizje
дволичност – dyfytyrësi
двосмислен – i dykuptimtë
дебата – debat
дејност – veprimtari
дејствие – veprim, aktivitet
дејство – efekt, veprim
декларација – deklaratë
делегирање – delegim
деликвент – delikuent
деликт – delikt
дело – vepër
деловно – afarist
деловност – afarist, afarizëm
делува – veproj
делумно – i pjesshëm
демант – demant, përgënjeshtrim
демаркација – demarkacion
должен – debitor, i obliguar
должник – borxhli, debitor, obligues
должност – detyrë, obligim
долупотпишаниот – i poshtënënshkruar
дом – odë, dhomë, shtëpi
доминација – dominim
домицилен – domicil
донација – donacion
донесува – miratoj, nxjerr
дополнение – plotësim
дополнет – i plotësuar
дополнителен – plotësues
долг – borxh, debit
должен – debitor, i obliguar
должник – borxhli, debitor, obligues
должност – detyrë, obligim
долупотпишаниот – i poshtënënshkruar
дом – odë, dhomë, shtëpi
доминација – dominim
домицилен – domicil
донација – donacion
донесува – miratoj, nxjerr
дополнение – plotësim
дополнет – i plotësuar
дополнителен – plotësues
дополнување – plotësim
доселеник – imigrant, ardhës
досие – dosje
демократија – demokraci
демократизира – demokratizoj
демонстрант – demonstrues
денационализација – denacionalizim
депозит – depozitë
депортација – deportim
дерогација – derogim

дестабилизација – destabilizim
дестинација – destinacion
детален – i detajuar
дефицит – deficit
деформација – deformoj
децентрализација – decentralizim
диктат – diktat
диктатор – diktator
диктатура – diktaturë
дилема – dilemë
дилер – diler
дипломатија – diplomaci
директива – direktivë
директор – drejtor
дирекција – drejtori
дисидент – disident
дисквалификација – diskualifikim
дискредитира – diskreditoj
дискриминација – diskriminim
дискреционен – diskrecional
дискусија – diskutim
диспозитив (изрека) – dispozitiv
дистрибуција – distribuim, shpërndarje
дневен ред – rend dite
добивка – fitim, dobi
добронамерен – qëllimmirë
доверба – mirëbesim, besim
доверител – kreditor
доверлив – konfidencial, i besueshëm
доверливост – konfidencialitet, besueshmëri
доверува (се) – i besohet
догма – dogmë
договара – kontraktoj, arrij marrëveshje
договарање – arritje marrëveshje, kontraktim
договор – marrëveshje, kontratë, traktat, pakt
договорен – marrëveshjesor, kontraktues
додаток – shtesë, suplement
доделува – ndaj, jap
доживотен – i përjetshëm
дозвола – leje
докажува – dëshmoj, jap prova
доказ – dëshmi, provë
доказен – i dëshmisë, i provës
документ – dokument
долг – borxh, debit
депортација – deportim
дерогација – derogim
дестабилизација – destabilizim
дестинација – destinacion
детален – i detajuar
дефицит – deficit
деформација – deformoj
децентрализација – decentralizim
диктат – diktat
диктатор – diktator
диктатура – diktaturë
дилема – dilemë
дилер – diler
дипломатија – diplomaci
директива – direktivë
директор – drejtor
дирекција – drejtori
дисидент – disident
дисквалификација – diskualifikim
дискредитира – diskreditoj
дискриминација – diskriminim
дискреционен – diskrecional
дискусија – diskutim
диспозитив (изрека) – dispozitiv
дистрибуција – distribuim, shpërndarje
дневен ред – rend dite
добивка – fitim, dobi
добронамерен – qëllimmirë
доверба – mirëbesim, besim
доверител – kreditor
доверлив – konfidencial, i besueshëm
доверливост – konfidencialitet, besueshmëri
доверува (се) – i besohet
догма – dogmë
договара – kontraktoj, arrij marrëveshje
договарање – arritje marrëveshje, kontraktim
договор – marrëveshje, kontratë, traktat, pakt
договорен – marrëveshjesor, kontraktues
додаток – shtesë, suplement
доделува – ndaj, jap
доживотен – i përjetshëm
дозвола – leje
докажува – dëshmoj, jap prova
доказ – dëshmi, provë
доказен – i dëshmisë, i provës
документ – dokument
достапен – i arritshëm, i aksesshëm
достапност – arritshmëri, akses
достигнување – arritje
достоинство – dinjitet
доход – të ardhura
доходовен – fitimprurës
држава – shtet
државен – shtetëror
државјанин – shtetas
државјанство – shtetësi
државник – burrështetas
друштво – shoqëri
дупликат – dublikatë

Е

евакуира – evakuoj
евентуалност – eventualitet
Европска заедница – Komuniteti Evropian
Европска комисија – Komisioni Evropian
Европска унија – Bashkimi Evropian
Европски парламент – Parlamenti Evropian
Европски совет – Këshilli Evropian
егзеутор – ekzekutues
егзил – ekzil
единица – njësi
едногласно – njëzëri, unanimisht
едностран – i njëanshëm
еколошки – ekologjik
економски – ekonomik
екслузивен – ekskluziv
експатријација – dëbim
експерт – ekspert

експропријација – shpronësim, eksproprijim
екстериторијалност – eksterritorialitet
екстрадира – ekstradoj
ефект – efekt

Ж

жалба – ankesë
жалбен – ankimor, apelues
жалител – ankues
живеалиште – vendbanim
животна средина – mjedis jetësor
жирант – zhirant, garant
жител – banor
жртва – viktimë
жртвување – viktimizim

З

забелешка – vërejtje, shënim
заблуда – mashtrim, lajthim
забрана – ndalim
забранет – i ndaluar
забранува – ndaloj
забрзува – përshpejtoj
заведува – mashtroj, regjistroj
заведувач – mashtrues
заведување – shënoj, evidentoj, regjistroj
завера – konspiracion, komplot
заверен – i verifikuar
заверува – verifikoj
завештание – pasuri trashëgimore
завештател – testator, trashëgimlënës
зависен – i varur
зависност – varshmëri
загадување – ndotje
загадувач – ndotës
заговор – komplot
заговорник – konspirator, komplotist
загуба – humbje
задача – detyrë
задоволителен – i kënaqshëm
задолжен – i ngarkuar, i obliguar
задолжение – obligim, detyrë
задолжителен – i detyrueshëm, i obligueshëm
задолжување – hyrje në borxh, marrje borxh
заедница – komunitet, bashkësi
заеднички – i përbashkët
заем – hua
заемодавач – huadhënës
заемопримач – huamarrës
закана – kërcënim, kanosje
(се) заканува – kanoset, kërcënohet
заклетва – betim
заклучок – konkluzion, përfundim
заклучува – konkludoj
закон – ligj
законик – kod
законитост – ligjshmëri
законодавна власт – pushtet ligjvënës
законодавство – legjislacion
законски – ligjor
закуп – qiramarrje
закупец – qiramarrës
закупнина – qira
закуподавач – qiradhënës
залагање – zotim
залог – peng
залогодавач – penglënës
залогопримач – pengmarrës
заложен – i lënë peng
заложник – peng
заменик – zëvendës
заменлив – i shkëmbyeshëm
заобиколен – tërthor, i tërthortë
заобиколува – bishtëroj
записник – procesverbal
запленува – konfiskoj, sekuestroj
запленување – konfiskim, sekuestrim
започнува – nis
запуштање – lënie pasdore
заострување – acarim, ashpërsim
засегнат – i interesuar, i prekur
заседава – mbaj mbledhje, kryeson
засилен – intensiv, më i fortë
заслуга – meritë
застапник – përfaqësues
застапништво – përfaqësi
застапува – përfaqëson
застапување – përfaqësim
застарен – i parashkruar
застареност – parashkrim
застарува – parashkruhet
застрашува – frikësoj
застрашување – frikësim
затајување – fshehje
затвор – burg
затвора – mbyll, arrestoj, burgos
затворање – mbyllje, arrestim, burgosje
затворен – i mbyllur, i burgosur
затвореник – i burgosur
зацврстува – forcon
зачленување – anëtarësim
заштита – mrojtje
збирка – përmbledhje
збор – fjalë
зголемување – rritje, ngritje, zmadhim
зделка – transaksion
здобива – fitoj
здобиен – i fituar
здружение – shoqatë
здружување – bashkim
зема – marr
земање – marrje
земјиште – tokë
земјоделски – bujqësor
злоба – keqdashje
злодело – krim
злоставување – keqtrajtim
злостор – krim
злосторник – kriminel
злосторство – krim
злоупотреба – keqpërdorim, shpërdorim, abuzim
злоупотребува – keqpërdor, shpërdoroj, abuzoj
знак – shenjë, sigël
значаен – i rëndësishëm
зона – zonë

И

идентичен – identik

избегнува – iki, bishtëroj, shmang
избегнување – shmangie, bishtërim
избира – zgjedh
избирач – zgjedhës
избирање – zgjedhje
избор – zgjedhje
изборен – zgjedhor
избори – zgjedhje
избран – i zgjedhur
избришан – i shlyer
изведба – realizim
изведува – nxjerr (si përfundim), konkludoj
изведување – nxjerrje, konkludim
изведувач – realizues
известува – njoftoj, bëj të ditur
известување – njoftim
извештај – raport
извинување – kërkoj falje (ndjesë)
извлекува – nxjerr (si përundim)
извод – certifikatë, ekstrakt
извор – burim
изворен – burimor
извршен – ekzekutiv
извршува – bëj, kryej, ekzekutoj, zbatoj
извршување – ekzekutim, përmbarim
извршител – përmbarues, ekzekutues
изговор – pretekst, shkak, arsyetim
изготвува – hartoj, përpiloj, përgatit
издава – lëshoj, jap
издавање – dhënie
издаток – shpenzim, kosto
издржување – vuajtje, mbajtje, ushqim
издршка – kujdes, mbajtje, ushqim
изедначување – nivelim, barazim, sheshim
изземен – përjashtohet
изигрување – bishtërim
изјава – deklaratë
изјавува – deklaroj
изјаловува – e bën më të pafrytshëm
изјаснување – deklarim
излагање – paraqitje, fjalim, ekspoze
излез – dalje, rrugëdalje, rrugëzgjidhje
измама – mashtrim
измамник – mashtrues
измачува – mundoj
измена – ndryshim, modifikim
изменет – i ndryshuar
изменува – ndryshoj
измислува – shpif, trillon
изнајмува – jap me qira
изнесува – nxjerr, prezanton
износ – shumë
изнуда – shantazh
изнудува – shantazhoj, bëj shantazh
изолира – izoloj
изработка – përpilim, hartim
изработува – përpiloj, hartoj
израз – shprehje
изразување – shprehja, të shprehurit
изрекува – shqiptoj
илегалец – ilegal
илегално – ilegalisht, në mënyrë ilegale
имател – zotërues, posedues
име – emër
именува – emëroj
имиграција – imigracion
имигрира – imigroj
имот – pronë, pasuri
имплементација – implementim, zbatim
имунитет – imunitet
инаугурација – përurim, inaugurim
инвалидност – invaliditet
инвестирање – investim
индиректен – i tërthortë, indirekt
индискретен – indiskret
иницијатива – nismë, iniciativë
иницијатор – nismëtar, iniciator
иницирање – nismë, inicim
инкорпорација – inkorporatë
инкриминација – inkriminim
инсолвентност – paaftësi pagese, insolvencë
инспектор – inspektor
инспекција – inspeksion
институт – institut
институција – institucion
инструкции – instruksione
инструмент – instrument
интеграција – integrim
интегритет – integritet
интервенција – intervenim
интервју – intervistë
интерес – interes
интернација – internim
интерниран – i internuar
интерпелација – interpelancë
интерпретација – interpretim
инфраструктура – infrastrukturë
инцест – incest
инцидент – incident
исказ – deklaratë, dëshmi
исклучив – ekskluziv, i veçantë
исклучиво – ekskluzivisht
исклучок – përjashtim
исклучување – përjashtim
искористува – shfrytëzoj
испит – provim
испитува – ekzaminoj, hulumtoj, marr në pyetje
испитување – hulumtim, ekzaminim, marrje në pyetje
исплата – pagesë, pagim
исплатница – fletëpagesë
исполнува – plotëson, përmbush
исполнување – plotësim, përmbushje
испорака – dërgesë, livrim
исправа – dokument
исправен – korrekt, i saktë, i drejtë
исправка – korrigjim, korrektim
испраќа – dërgoj
испраќач – dërgues
испробан – i privuar, i testuar

истекување – skadim, skadencë
истрага – hetim
истражува – hetoj
истражување – hetim, kërkim, gjurmim
истражувач – hulumtues, kërkues, investigues
истражител – hetues
истрел – krismë
исцрпен – i hollësishëm
итно – urgjent

Ј

јавен – publik
јавен интерес – interes publik
јавен обвинител – prokuror publik
јавен оглас – shpallje publike
јавен правобранител – avokat publik
јавен ред – rend publik
јавен сектор – sektor publik
јавен службеник – nëpunës publik
јавна администрација – administratë publike
јавна безбедност – siguri publike
јавна служба – shërbim publik
јавна расправа – debat publik
јавна институција – institucion publik
јавно гласање – votim publik
јавно здравство – shëndet publik
јавно обвинителство – prokurori publike
јавно судење – gjykim publik
јакнење – forcim, konsolidim
јасен – i qartë

К

каење – pendesë, pendim
кабинет – kabinet
каботажа – kabotazh
кадар – personel
кадровски – personeli, i personelit
казна – dënim, ndëshkim
казнен – ndëshkues, ndëshkimor, penal
казнено поправен дом – shtëpi ndëshkuese korrektuese
казнет – i dënuar, i ndëshkuar
казнив – i dënueshëm, i ndëshkueshëm
казнува – dënoj, ndëshkoj
казнување – dënim, ndëshkim
калибар – kalibër
калибрира – kalibroj
камата – kamatë, interes
затезна камата – kamatëvonesë
камата на главница – kamatë e kryegjësë
каматна стапка – shkallë (nivel) kamator/e
кампања – fushatë
кандидат – kandidat
кандидирање – kandidim
канцеларија – zyrë
капар – kapar
капитал – kapital
каса – arkë
кауција – garanci, depozitë
квази – kuazi, pseudo
квалификација – kualifikim
ловокрадство – gjueti ilegale (pa leje)
лоза – brez, fis, trung
лојалност – lojalitet
локална – lokal
квалификуван – i kualifikuar
кворум – kuorum
квота – kuotë
киднапер – rrëmbyes, kidnapues
киднапира – rrëmbej, kidnapoj
класификација – klasifikim
клаузула – klauzolë
клеветење – shpifje
клевети – shpif
клеветник – shpifës
клиент – klient
клупа – bankë
книга – libër
книговодител – kontabilist
книшка – librezë
кодекс – kodeks
кодош – kodosh, spiun, denoncues
кодошење – spiunim, përgojim
количина – sasi, vëllim
команда – komandë
командување – komandim
комесар – komisar
комисија – komision
комисионер – komisionar
комитет – komitet
комора – dhomë, odë
компанија – kompani
компензација – kompensim
комплот (завера) – komplot
комуникација – komunikim
конвенција – konventë
конечен – final, përfundimtar, definifiv
конзорциум – konsorcium
конзул – konsull
конзулат – konsullatë
конкуренција – konkurencë
консензуален – konsensual
консензус – konsensus
консолидира – konsolidon
конструктивен – konstruktiv
консултант – konsultant
консултативен – konsultativ
консултации – konsultime
контакт – kontakt
контаминација – kontaminim
контекст – kontekst
контрабанда – kontrabandë
контра предлог – kundërpropozim
контрола – kontroll
контролор – kontrollor
конфедерација – konfederatë
конференција – konferencë
конфискува – konfiskoj
конфискување – konfiskim
конфликт – konflikt
концесија – koncesion
концесионер – koncesioner
координатор – koordinator
координира – koordinoj
копија – kopje

корисник – përdorues, shfrytëzues
корист – dobi
користољубие – përfitim
корпорација – korporatë
корупција – korrupsion
краде – vjedh
крадец – vjedhës
кражба – vjedhje
краен – final, përfundimtar
краткотраен – afatshkurtër
кредибилитет – kredibilitet
кредит – kredi
кредитирање – kreditim
кредитор – kreditor
кривоклетник – dëshmitar i rremë
кривоклетство – dëshmi e rremë, deklarim i rrejshëm
криза – krizë
криминал – kriminalitet
криминален – kriminal
криминалец – kriminel
криминологија – kriminologji
критериум – kriter, kriterium
